



Aplikim për vizë me qëllim bashkimin e një prindi me fëmijën me nënshtetësi gjermane
(edhe në kuadër të udhëtimit të përbashkët)

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhënë bashkëngjitur. Duke qenë i/e përgatitur mirë ju mund të ndikoni pozitivisht dhe të shkurtoni procedurën përkatëse.

I gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet në origjinal!

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada, si rregull, duhet të përfshijë në procedurë zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Për këtë arsye procedurat zgjasin zakonisht 8 deri në 10 javë, në raste të veçanta edhe më gjatë. Ndaj lutemi për mirëkuptimin Tuaj për faktin që brenda 8 javëve të para, prej ditës së aplikimit, nuk mund t'u japim përgjigje pyetjeve lidhur me stadin aktual të procedurës.

Të gjitha dokumentat që tërhiqen pranë Ambasadës (fletët e informacionit, formularët e aplikimit) janë gratis. Të gjitha informacionet rreth procedurës së aplikimit i gjeni në faqen e internetit të Ambasadës.

Lutemi të vini re udhëzimet e dhëna për çdo pikë, në mënyrë të veçantë numrin e kopjeve të nevojshme.		
1.	Pashaporta e udhëtimit <i>+ 2 kopje (të gjitha faqet e rëndësishme)</i>	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
2.	2x formularë aplikimi për vizë	Në gjermanisht ose anglisht, të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkruara personalisht.
3.	2x fotografi	2 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj.
4.	Tarifa	Tarifa është 60 €, e pagueshme në Lek, plus një tarifë e përgjithshme për shpenzime telefonike prej 500 Lekësh
5.	Çertifikatë lindjeje e fëmijës <i>+ 2 kopje</i>	Origjinali i certifikatës gjermane të lindjes. Nëse fëmija nuk ka lindur në Gjermani: Certifikatat që nuk janë në gjuhën gjermane dhe nuk lëshohen sipas një formulari ndërkombëtar duhet të përkthehen dhe të legalizohen.

		Përkthimi duhet të jetë i noterizuar. Duhet të dorëzohen nga dy kopje për certifikatën dhe përkthimin. Certifikatat shqiptare me formular ndërkombëtar NUK kanë nevojë të përkthehen, por duhet të legalizohen. Duhet dorëzuar dy kopje të certifikatës.	
6.	Dëshmi për shtetësinë e fëmijës <i>+ 2 kopje</i>	Duhet të paraqitet dëshmi për shtetësinë <u>ose</u> kopje e pashaportës gjermane	
7.	Nëse duhet, dëshmi për të drejtën e rritjes dhe edukimit <i>+ 2 kopje</i>	Dëshmi që prindi në fjalë ka të drejtën e rritjes dhe edukimit mbi fëmijën; dhe kjo bëhet përmes një certifikate martese ose një deklarate noteriale lidhur me të drejtën gjermane të rritjes dhe edukimit	
8.	Vërtetim i vendbanimit <i>+ 2 kopje</i>	Dëshmi e vendbanimit në Gjermani përmes vërtetimit të Zyrës së Regjistrimit (lëshuar jo më herët se 6 muaj)	
Nëse fëmija nuk ka lindur ende, por me lindjen e tij pritët që ai të marrë shtetësinë gjermane – duhen edhe:			
10.	Vërtetim i shtatzanisë <i>+ 2 kopje</i>	Vërtetim aktual i mjekut për shtatzaninë dhe datën e parashikuar të lindjes, me përkthimin përkatës	
11.	Dëshmi e shtetësisë <i>+ 2 kopje</i>	Dëshmi për shtetësinë e ardhshme gjermane të fëmijës, për shembull përmes certifikatës së martesës të prindërve ose përmes njohjes së atësisë sipas ligjit.	

Në raste të veçanta, gjatë aplikimit apo procedurës së vizës, mund të kërkohen dokumenta të caktuara të papërmendura më sipër.